



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:224374
Datë: 03.06.2022
Numri i dokumentit: 03095162

K. Nr. 1006/21

Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje, Gjyqtari Menderes Behluli, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit SH.I nga fsh.K. Gjilan, për shkak të veprës kundërvajtëse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 3, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr., 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, e konform nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119, dhe 124, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë **03.06.2022** shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit SH.P nga babai....., i lindur me datë....., në fsh..... K. Gjilan, me numër personal:....., ku edhe jeton, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datën **21.09.2021** rreth orës **15:30 min**, është takuar në territorin e fshatit, në vendin e quajtur “.....”, duke prerë me sharrë motorike dru të njoma bungu, gjithsej 118 copa me diametër 8-10cm, dhe gjatësi 5m, me vëllim prej 1.95 m³, më vlerë prej 249.60 euro, të cilat i transportonte me traktor “**Stoyer**” me ram, dhe i njëjti është recidivist.

- me ç ‘veprim ka kryer veprën kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 3, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3, për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, andaj

D Ë N O H E T

Me dënim me gjobë në larësi prej **300 (treqind) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në kuptim të nenit 163p. 3 të LK.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi l pika 6, të LMK-së.

Nga një kopje e aktgjykimit t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

A.P.K-ja, në Gjiilan, me datën **22.09.2021**, ka paraqitur kërkesën me nr. **170/21**, për inicimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të lartshënuar dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike ftoj me ftesë të pandehurin për datën **23.03.2021**, për të dhënë mbrojtjen në gjykatë, mirëpo edhe pse i njëjti ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregull të mos ardhjen nuk e ka arsyetuar dhe për të njëjtin gjyqtarin vendosi në mungesë pa e marr të njëjtin në pyetje konform nenit **48 pra 2 të LMK-së**, pasi që vepra kundërvajtëse bindshëm vërtetohet nga shkresat e lëndës dhe deklaratës së dëshmitarit- pylltarit në seancës gjyqësore.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike mori në pyetje edhe personin zyrtar, pylltarin O.I në cilësinë e dëshmitarit i cili deklaroi se është e vërtetë se me **dt.21.09.2021**, në orën **13:30min**, të lartpërmendurin e kam takuar në territorin e fshatit Pogragj, në vendin e quajtur "**Rrezja e Grajevcit**" duke prerë me sharrë motorike dru të njoma bungu, ku kishte prerë 118 copa, me diametër 8-10cm, me gjatësi 5 m, me vëllim prej 1.95m³, dhe agjensionit i ka shkaktuar dëm prej 249.60 euro. Dhe të cilat dru i transportonte me traktor "**Stoyer**" me ram, dhe është recedivist.

Andaj gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe deklaratës së dëshmitarit erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë prova të mjaftueshme, se i pandehuri është kryerës i veprës kundërvajtës prerje dhe-transportimi ilegal i druve, vepër kjo e paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 3, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr- 2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës të aprovuar nga Kuvendit i Kosovës, për të cilën të njëjtin e shpalli përgjegjës dhe e ndëshkoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit, pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 p 1 të LMK-së, dhe të njëjtit i shqiptoi këtë dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, me bindje se edhe me një dënim të këtillë do të arrihet efekti i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla kundërvajtëse .

Numri i lëndës: 2021:224374
Datë: 03.06.2022
Numri i dokumentit: 03095162

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej 5 €, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi I pika 6, të LMK-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni për Kundërvajtje,
Me datë 03.06.2022**

Praktikantja,
Vjollca Shabani

Gjyqtari,
Menderes Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.